



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 6, datë 19/02/2015

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME BAZË MBI
METODOLOGJINË E VLERËSIMIT TË RISKUT”**

Në zbatim të nenit 16, pika 2, germa c të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”,

URDHËROJ:

1. Miratimin dhe zbatimin e Rregullave të Përgjithshme bazë mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut
2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

Adresa: Rruga: “Frosina Plaku” Nr. 58, Godina e Observatorit Kati 0, Tiranë.
Tel: 042 229765, Fax: 042 228983
www.inspektoratiqendror.gov.al

3. Ky urdhër publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror, www.inspektoratiqendror.gov.al, si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM



RREGULLA TË PËRGJITHSHME BAZË MBI METODOLOGJINË E VLERËSIMIT TË RISKUT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Kjo rregullore përcakton rregullat e përgjithshme bazë mbi metodologjisë e vlerësimit të riskut për sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit, për funksionet e inspektimit që rregullon Ligji për Inspektimin.
2. Kjo rregullore është e zbatueshme nga institucionet qendrore të ngarkuara me një ose disa funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të Ligjit për Inspektimin.

Neni 2

Përkufizime

1. “Inspektim” është çdo formë kontrolli që inspektorati kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.
2. “Kërkesat ligjore” janë kërkesat e përcaktuara nga një ligj, akt nënligjor apo një leje, licencë a autorizim dhe që janë të detyrueshme për t’u respektuar gjatë ushtrimit të një veprimtarie të natyrës tregtare, ekonomike apo profesionale, përfshirë ato kërkesa të detyrueshme për t’u respektuar nga organet publike që ofrojnë shërbime publike.
3. “Ligji për Inspektimin” është ligji nr 10433, date 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. “Objekt inspektimi” është çdo akt, produkt, shërbim, process, asset, hapësirë publike ose private, posedimi, kryerja ose përdorimi i të cilave nga subjektet e inspektimit krijojnë detyrimin e respektimit të një kërkesë ligjore.
5. “Risk” është gjasa që një ngjarje e padëshiruar, e nënkuptuar si dëm ose lëndim, të ndodhë.
6. “Sektor inspektimi” është bashkësia e subjekteve të ndryshme të grupuara sipas disa karakteristikave të veçanta, që kanë detyrimin të respektojnë një kërkesë ligjore.
7. “Subjekti i inspektimit” është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik, që ka, sipas ligjit, detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.
8. “Inspektoratet” janë inspektoratet shtetërore, inpektoratet vendore dhe inspektorat shtetërore pjesë përbërëse e një institucioni të ngarkuar me një apo disa funksione inspektimi.
9. “Baza e të dhënave” është informacioni që kanë inspektoratet mbi sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit në një ambient elektronik.

10. "Përputhshmëri" është respektimi i kërkesave ligjore nga sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit.

Neni 3

Qëllimi

Vlerësimi i riskut është një procedurë sistematike dhe e vazhdueshme e inspektorateve shtetërore që ka për qëllim shqyrtimin, identifikimin, përcaktimin dhe kategorizimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit në bazë të riskut që ato prodhojnë ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

KREU II

KATEGORIZIMI NË BAZË RISKU

Neni 4

Krijimi i bazës së të dhënave

Inspektoratet shtetërore krijojnë një bazë të dhënash për sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit në fushën e tyre të veprimit, ku mund të ushtrojnë funksione inspektimi.

Neni 5

Përmbajtja e bazës së të dhënave

Baza e të dhënave të inspektorateve shtetërore përmban informacion mbi riskun që prodhojnë:

1. Sektorët e inspektimit në fushën e veprimit të inspektorateve shtetërore;
2. Subjektet e inspektimit në fushën e veprimit të inspektorateve shtetërore;
3. Objektet e inspektimit në fushën e veprimit të inspektorateve shtetërore.

Neni 6

Standardizimi i informacionit mbi riskun

Inspektoratet shtetërore përpunojnë dhe kategorizojnë informacionin përshkrues të mbledhur rreth subjekteve të inspektimit me qëllim evidentimin e faktorëve të riskut të cilët shprehen nëpërmjet treguesve specifikë të riskut.

Neni 7

Faktorët e riskut

1. Inspektoratet shtetërore përcaktojnë faktorët e riskut të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit, në bashkëpunim me komunitetin shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Faktorët e riskut ndahen në faktorë risku të lidhur me gjasat për pa-përputhshmëri dhe në faktorë risku të lidhur me efektin e pa-përputhshmërisë.
3. Gjasat për pa-përputhshmëri lidhen me historikun e përputhshmërisë dhe shprehin tendencën e sektorëve dhe subjekteve të inspektimit ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë..

4. Efekti i pa-përputhshmërisë lidhet me dëmin dhe lëndimin që do të shkaktohej në rast pa-përputhshmërie dhe shpreh ndikimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.
5. Faktorët e riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të ndryshimeve të kërkesave ligjore për t'u respektuar nga sektorët, subjektet dhe objektet e inspektimit, si dhe tendencës që shfaqet për papërputhshmëri me to.
6. Faktorët e riskut të lidhur me efektin e papërputhshmërisë përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të evidencave të reja mbi ndikimin e sektorëve dhe subjekteve ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridike.

Neni 8

Treguesit e faktorëve të risku

1. Inspektoratet shtetëore përcaktojnë treguesit e faktorëve të riskut të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit, në bashkëpunim me komunitetin shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Treguesit e faktorëve të riskut shprehin në mënyrë sasiore/cilësore peshën e riskut brenda të njëjtit faktor risku dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm të riskut.
3. Treguesit e faktorëve të riskut duhet të jenë të agregueshëm në një shumatore të përgjithshme për të gjithë faktorët e riskut.
4. Pesha e treguesve të faktorëve të riskut përditësohen në bazë të prioriteteve të inspektorateve, si dhe historikut të inspektimeve të sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit.

Neni 9

Përcaktimi i riskut të përgjithshëm

1. Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri dhe efektin e papërputhshmërisë të sektorëve të inspektimit agregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo sektor inspektimi (Risku i Sektorit).
2. Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me efektin e papërputhshmërisë të objekteve të inspektimit agregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo objekt inspektimi (Risku i Objekteve).
3. Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të lidhur me gjasat për papërputhshmëri të subjekteve të inspektimit agregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për gjasat për pa-përputhshmëri për çdo subjekt inspektimi (Risku i Gjasave për Papërputhshmëri).
4. Treguesit (vlerat) e faktorëve të efektit për papërputhshmëri të subjekteve të inspektimit, Risku i Sektorit (vlera) dhe Risku i Objektit (vlera) me të cilin/ët subjekti i inspektimit është i lidhur, agregohen në një shumatore të përgjithshme duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për efektin e pa-përputhshmërisë

për çdo subjekt inspektimi (Risku i Efektit të Papërputhshmërisë).

KREU III HEDHJA E TË DHËNAVE NË PORTALIN “e-INSPEKTIMI”

Neni 10

Matrica e vlerësimit të riskut

- Vlerësimi i riskut në ambjentin e portalit “e-Inspektimi” bëhet në bazë të matricës së vlerësimit të riskut, e cila kategorizon vetëm subjektet e inspektimit:

	Gjasat për pa-përputhshmëri					
	+	1	2	3	4	5
Efekti i pa-përputhshmërisë	5	6	7	8	9	10
	4	5	6	7	8	9
	3	4	5	6	7	8
	2	3	4	5	6	7
	1	2	3	4	5	6
	0	1	2	3	4	5

- Kategoria e riskut përcaktohet nga vlera e Riskut të Përgjithshëm të subjektit të inspektimit që përfshin numrat e plotë në intervalin 2-9.
- Vlera e Riskut të Përgjithshëm përcaktohet nga shuma e vlerës së Riskut të Gjasave për Papërputhshmëri dhe vlerës së Riskut të Efektit të Papërputhshmërisë.
- Vlera e Riskut të Gjasave për Papërputhshmëri përfshin numrat e plotë në intervalin 1-5.
- Vlera e Riskut të Efektit për Papërputhshmëri përfshin numrat e plotë në intervalin 1-5.
- Në kuptimin e kësaj matrice, Risku i Përgjithshëm, Risku i Gjasave për Papërputhshmëri dhe Risku i Efektit për Papërputhshmëri rriten në varësi të rritjes së vlerës numerike.

Neni 11

Përshtatja e vlerave të riskut

Inspektoratet shtetëore, në bashkëpunim me komunitetin shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit dhe duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare e

ndërkombëtare, duhet të përcaktojnë pesë intervale klasifikimi të vlerave të treguesve të përgjithshëm të Riskut të Gjasave për Papërputhshmëri dhe Riskut të Efektit për Papërputhshmëri, për t'ju përshtatur vlerave përkatëse të riskut të matricës së vlerësimit të riskut në ambientin e portalit “e-Inspektimi”

Neni 12

Hedhja e të dhënave dhe publikimi i faktorëve dhe treguesve të riskut

1. Inspektoratet shtetëore duhet të publikojnë dhe përditësojnë në portalin “e-Inspektimi” Faktorët e Gjasave për Papërputhshmëri dhe Faktorët e Efektit për Papërputhshmëri, peshën dhe treguesit e tyre, në mënyrë që subjektet e inspektimit të përgjegjësohen dhe të pozicionohen qartë për ndikimin e tyre ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, si dhe për tendencën që duhet të kenë në respektimin e kërkesave ligjore.
2. Hedhja e të dhënave për riskun në Matricën e Vlerësimit të Riskut bëhet në mënyrë periodike ose në vazhdimësi, në varësi të specifikave të inspektorateve shtetërore.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Përcaktimi i nëpunësve përgjegjës

1. Titullari i inspektoratit autorizon nëpunësit përgjegjës, të cilët nuk duhet të ushtrojnë funksione inspektuese, për përcaktimin e faktorëve të riskut, peshës dhe treguesve të tyre.
2. Në përmbushjen e detyrës së ngarkuar, nëpunësit përgjegjës sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të mbështeten nga komuniteti shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit.
3. Titullari i inspektoratit autorizon nëpunësit përgjegjës, të cilët nuk duhet të ushtrojnë inspektuese, për hedhjen e vlerave të Riskut të Gjasave për Papërputhshmëri dhe të Riskut të Efektit të Papërputhshmërisë për çdo subjekt inspektimi, në portalin “e-Inspektimi”.

Neni 14

Përcaktimi i afateve

1. Inspektoratet miratojnë brenda tre mujve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje faktorët e riskut sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.
2. Inspektoratet miratojnë brenda tre mujve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të treguesve të faktorëve të riskut sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.
3. Inspektoratet kanë afat tre mujor nga përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni për përcaktimin e riskut të përgjithshëm sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje.
4. Inspektoratet kanë afat tre mujor nga përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në pikën

1 dhe 2 të këtij neni për përshtatjen e vlerave të riskut me matricën e vlerësimit të riskut sipas nenet 10 të kësaj rregulloreje.

5. Inspektoratet kanë afat një muaj nga përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje për hedhjen e të dhënave në portalin “e-Inspektimi” sipas nenet 12 të kësaj rregulloreje.